

NAIM BERISHA

**LESIKU MBI PJESËT E SHTËPISË DHE ORENDITË SHTËPIAKE
NË TREVËN E GJAKOVËS**

Gjuha si një “organizëm i gjallë”, në vetvete përmban “grimca historie” me të cilat rrugëton në periudha të gjata kohore. Treva e Gjakovës si pjesë e grupit të folmeve verilindore të gegërishtes shquhet për zhvillime interesante në fushën e leksikut. Gjakova si qytet, për breza me radhë shërbeu si qendër e rëndësishme e asaj ane, sidomos e Rrafshit të Dukagjinit. Pra, duke qenë një “udhëkryq” i rëndësishëm në zhvillimin e kontakteve të shumëllojshme, aty u gërshetuan edhe elemente gjuhësore nga treva të tjera por edhe fjalë të huazuara.

Në këtë vështrim, nga korpusi i përgjithshëm leksikor i kësaj treve, për objekt trajtimit e kemi marrë leksikun që lidhet me pjesët e shtëpisë dhe orenditë shtëpiake. Në kuadër të kësaj, aq sa na lejon formati i këtij prezantimi, do të mundohemi që t’i paraqesim përmbledhtas disa rezultate të nxjerra nga hulumtimi që e kemi bërë në terren. Vëmendje të veçantë u kemi kushtuar fjalëve që kanë statusin e përdorimit aktiv në të folur dhe që paraqesin veçanti në raport me të folmet përreth apo me leksikun e shqipes standarde. Materialet e mbledhura dhe të trajtuara, duke u bazuar në literaturën të cilën e kemi përdorur, nuk i kemi hasur të mbledhura apo të studiuara.

Dihet se kontaktet e botës shqiptare me kulturën orientale përgjatë historisë kanë krijuar kushte që shqipja të ndikohet dhe të huazojë fjalë. Ashtu siç e përmendëm, edhe në periudhën e sundimit osman Gjakova ishte qendër e rëndësishme politike, administrative e kulturore e asaj ane. Si rrjedhim i kësaj, depërtimi i orientalizmeve u bë më i lehtë dhe më i vëllimshëm. Në kushte të këtilla, një numër i konsiderueshëm i fjalëve që lidhen me sferën për të cilën po shkruajmë na dalin të jenë orientalizma. Në përgjithësi, fondi leksikor i orientalizmeve që kanë arritur të kenë përdorim në gjuhën shqipe është i madh, pjesa dërmuese e tyre i përket leksikut të mbarë shqipes. Pra, ashtu si në të gjitha të folmet e tjera shqipe, edhe në të folmen e Gjakovës hasim një numër të konsiderueshëm fjalësh me burim oriental.

Prania e orientalizmeve në këtë masë në leksikun e kësaj treve, përveç rrethanave të përgjithshme historike, politike e kulturore, ndoshta mund të arsyetohet me faktin se qyteti i Gjakovës fillet e organizimit dhe të funksionimit si qendër më e madhe banimi i ka në kohën e Perandorisë Osmane. Bashkë me themelimin e qytetit e krijua edhe një “frymë jetese” gati gjysmë orientale. Si faktor i rëndësishëm në këtë proces ka ndikuar edhe përkatësia fetare e popullsisë së kësaj treve që është kryesisht myslimane.

Duke u bazuar në kriterin e përmendur më lart, klasifikimi e sistemimi i këtij materiali na rezultoi se numri më i madh i këtyre fjalëve që emërtojnë pjesët e shtëpisë dalin të jenë orientalizma.

Edhe pse depërtimi i fjalëve në një gjuhë nuk është “proces mekanik” i cili mund të orientohet, interesant del fakti se një numër i fjalëve që lidhen me këtë fushë leksikore, por edhe një numër fjalësh që lidhen me fusha të tjera leksikore, kanë përdorim vetëm brenda qytetit. Këto nuk i hasim në fondin leksikor të fshatrave përreth ose me përjashtime të rralla. Shembull i një konstatimi të tillë është fjala *xhyzenti*, - paradhomë, pjesa përpara dyerve të një shtëpie. Edhe pse e krahasuar me fondin e përgjithshëm leksikor të shqipes kjo fjalë mund të duket si arkaizëm apo huazim leksikor me status pasiv të përdorimit, në këtë trevë gjuhësore kjo fjalë ka përdorim aktiv. Për dallim nga qyteti, në fshatra e gjejmë të përdorur një gjegjëse me burim sllav *hodnik*¹, por edhe fjalën me burim oriental *hajat*². Fjala *hajat* nëpër fshatra ka kuptimin e korridorit brenda shtëpisë, kurse sipas “Fjalorit të shqipe së sotme” fjala *hajat* ka kuptimin: *Shesh përpara derës së një ndërtese, i shtruar me dhe të ngjeshur ose me rrasa, i mbuluar me çati të vendosur mbi shtylla dhe zakonisht i parrethuar me mur ose i rrethuar me mure të ulëta a me parmakë; treme*. Kur jemi te fjalët e burimit oriental, duhet theksuar se vërehet një dukuri interesante e lëvizjes kuptimore të tyre nga gjuha burimore në përdorimin që e kanë sot. Këtë dukuri e hasim pothuajse në të gjitha fushat leksikore që i kemi trajtuar.

Shembull tjetër i cili mund të lidhet me konstatimin e mësipërm është emërtimi për dhomën e fjetjes, *qile:r (qilár)* - sipas Tahir Dizdari³, kjo fjalë është e burimit oriental dhe ka kuptimin “ndarje brenda shtëpisë ku ruhen gjërat e ushqimore”. Këtë fjalë në fshatrat e Gjakovës e hasim me kuptim krejt tjetër, pra të dhomës së fjetjes. Në shumë raste ana kuptimore e kësaj fjale është tkurrur edhe më shumë, e ka kuptimin “dhoma e fjetjes së nuses”, sepse për dhomat tjera përdoret fjala *so:b*. Përdorimi i përditshëm i fjalëve në raport me leksikun e shqipes standarde nganjëherë del interesant, p.sh. fjala *so:b*, ashtu siç dihet, është e paraqitur me kuptimin: *Pajisje për të ngrohur një dhomë ose për të gatuar, zakonisht në trajtën e një kutie të madhe prej metali, prej balte etj., me vendin për të ndezur zjarrin dhe me qyngjet për të tërhequr tymin; stufë* (Fjalorin e shqipes së sotme 2002). Për emërtimin e shtëpisë përdoret fjala orientale “*japi*”, - *U ba me japi, Nuk ka Japi mi kry, etj.* Kjo fjalë ka një përdorim të shpeshtë nëpër fshatra, në qytet nuk e hasim, me përjashtim të rasteve të rralla. Fjalë tjetër interesante dhe që ka shtrirje kryesisht në qytet është fjala *ashqihane* – qilar (FGJSH), dhomë e veçantë e

¹ Grup autorësh, *Fjalor serbokroatisht shqip*, IAP, Prishtinë, 1986.

² Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.

³ Po aty.... f. 807.

ndërtuar në oborr të shtëpisë ku përgatitej ose ruhej ushqimi, bulmeti etj. Edhe te ky emërtim vërehet dallimi fshat – qytet në përdorimin e fjalëve dhe kuptimeve të tyre. Në fshatra përdoret fjala **çarranik**, e cila emërton të njëjtën gjë.

Lëvizje kuptimore ka pasur edhe te një numër fjalësh të cilat i ka mbarë shqipja. Fjala shtëpi në fjalorin e gjuhës shqipe e ka kuptimin e ndërtesës për të banuar, banesë. Ndonëse kjo fjalë në “Fjalori i shqipes së sotme”, në ligjërimin bisedor jepet me kuptimin *dhomë*, në leksikun e disa fshatrave në trevën e Gjakovës kjo është më e specifikuar, pra përdoret me kuptimin *dhomë e ndejës*, dhoma ku rrinë gratë dhe fëmijët, vatra. E gjejmë të përdorur edhe me togfjalëshin “*shpija e robe*”.

Interesant del përdorimi i fjalës **sepet**, - orientalizëm, sipas fjalorit të Dizdarit⁴ është mobile në formë arke që është përdorur për vendosjen e rrobave dhe gjërave të ndryshme. Përveç kuptimit që e ka nga gjuha bazë, kjo fjalë gati në shumicën e fshatrave të Gjakovës përdoret me kuptimin “**kosh buke**”, por e gjejmë të përdorur edhe me kuptim kosh për hedhjen e rrobave “**sepeti i teshave**”. Shembull tjetër i kësaj prirje është fjala **dysheklak**, (sipas fjalorit të Dizdarit⁵ ka kuptimin *e raftit të madh të vendosur brenda murit ku palosen dyshekë, jorganë, jastëkë, batanija*), në disa fshatra, kjo fjalë përdoret në kuptimin, - *Paradhomë e odës së burrave ku vendoseshin këpucët*. Përdorimi i kësaj fjale është më i izoluar, në disa fshatra nuk përdoret fare e madje nuk ia dinë as kuptimin.

Emërtim tjetër dygjymtyrësh është edhe fjala me burim oriental **ekmiqihane**, - furrë buke. Nga fjala turke **ekmek** - **bukë**, kemi rënien e dy shkronjave të fundit **ek** dhe tri shkronjave të ndërfutura për lehtësim shqiptimi **iqi**, si dhe prapashtesës **-hane** (kjo prapashtesë haset te disa emra që tregojnë vend, hapësirë dhe objekte të ndryshme). Kjo fjalë nuk ka shtrirje të madhe në përdorim, e hasim në raste të caktuara në qytet por jo edhe në fshatra. Me interes na është dukur edhe kompozita “**havalja aborrit**”. Këtu kemi dy fjalë të ndryshme edhe nga kuptimi edhe nga prejardhje. Njëra me burim oriental (havale) dhe tjetra me burim sllav (aborr/oborr), të dyja këto e formojnë kompozitën **havalja aborrit**, e cila përdoret për emërtimin e rrethojës së shtëpisë, qoftë prej gardhi apo prej muri. Baza logjike e formimit të kësaj kompozite në njëfarë forme pasqyron edhe mënyrën e të jetuarit dikur, ku familja në përgjithësi e gratë në veçanti duhet të mbroheshin nga ekspozimi me botën e jashtme. Kur jemi te huazimet nga gjuhët e tjera, sidomos ato të burimit sllav, duhet theksuar se kanë filluar të mënjanohej dhe nuk kanë përdorim të shpeshtë. Shembull për këtë është fjala **perzore**, e cila në përdorim e sotshëm është zëvendësuar pothuajse plotësisht me fjalën **dritare**.

⁴ Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.

⁵ Po aty... f. 241.

Për fund, mund të themi se njësitë leksikore të paraqitura në këtë punim janë një pjesë shumë e vogël e korpusit të përgjithshëm të njësive të mbledhura në trevën gjuhësore të Gjakovës, por, siç e theksuam më lart, këto i kemi për zgjedhur si njësi që kanë karakter kryesisht lokal dhe që lidhen me studimin tonë. Pjesa dërmuese e njësive të paraqitura në këtë punim mendojmë se nuk kanë shtrirje të gjerë gjeografike, gjithashtu nuk i kemi hasur të mbledhura apo të trajtuara në ndonjë studim tjetër.